



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“PËR PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN E FLETËVE
TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenin 20, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, Drejtoria e Ligjshmërisë ka hartuar projektvendimin “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, ka për qëllim vendosjen dhe përdorimin e kamerave regjistruese në Vendet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Referuar nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme video monitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave, në VNV-të, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Sistemi i video monitorimit nuk mund të instalohej në qendrat e votimit në mënyrë të tillë që të cenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit. Nëse nuk e kryen vetë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të video monitorimit.

Referuar nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerate me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .4.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN
E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE,
NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", të nenit 20, pika 2, shkronja "c", nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në Vendin e Numërimit të Votave, në zgjedhjet e për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve), dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data:..2023 Nr:
Ora:



"Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar